



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES**



VENDIM

Nr. 1 Date 28.01.2015

**PER MIRATIMIN E RAPORTIT TE ANALIZES EKONOMIKE-FINANCIARE TE
KESHILLIT TE QARKUT KUKES PER VITIN 2014**


Keshilli i Qarkut Kukës ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme pasi shqyrtoi Relacionin dhe P/Vendimin e paraqitur nga Sektori i Finances, bazuar ne ligjin Nr.8652, date, 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1/1/b, 8/1/III/c, 8/1/IV/b, 19/8,54, ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Proçedurave Administrative të RSH", ligjit Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise", udhezimit Nr.2, date 06.02.2012 "Per Proçedurat Standarte te zbatimit te buxhetit", urdherin e Ministrit te Financave Nr.8980, date 15.07.2010 "Per miratimin e manualit te menaxhimit financiar dhe kontrollit" shtojca Nr.11, pika f, si dhe ne vendimin e Kryesise se KQK-se Nr.1 date 28.05.2015,

VENDOSI:

1. Te miratoje Raportin e analizes ekonomike-financiare te Keshillit te Qarkut Kukës per vitin 2014, bashkangjitur ketij vendimi.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Keshillit te Qarkut Kukës, si dhe Drejtoria Juridike, Finances dhe MBNJ-se.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI

Ibsen ELEZI



Konc.M.Onuzi

Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari:B.Ngieçi

U hartua ne 3 (tre) kopje origjinale:

1.Zvres se Arkivit



RAPORT

PER MIRATIMIN E ANALIZES EKONOMIKE-FINANCIARE TE KESHILLIT TE
QARKUT KUKES PER VITIN 2014

Ne zbatim te ligjin Nr.8652, date, 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1/1/b, 8/1/III/c, 8/1/1/b, 19/8,54, ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Proçedurave Administrative të RSH", ligjit Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise", udhezimit Nr.2, date 06.02.2012 "Per Proçedurat Standarte te zbatimit te buxhetit", urdherin e Ministrit te Financave Nr.8980, date 15.07.2010 "Per miratimin e manualit te menaxhimit financiar dhe kontrollit" shtojca Nr.11, pika f, bashkangjitur ju paraqesim raportin:

"Per miratimin e analizes ekonomike-financiare te Keshillit te Qarkut Kukës per vitin 2014"

Ky raport, permban analizen e zbatimit te buxhetit vendor sipas vendimit te Keshillit te Qarkut Kukës Nr.8 date 06.02.2014 "Per miratimin e buxhetit te Keshillit te Qarkut Kukës per vitin 2014". Bazuar ne aktet ligjore dhe nenligjore te cituara me siper, Keshilli i Qarkut Kukës ka ushtruar detyrat dhe kompetencat e tij financiare ne baze te planifikimit vjetor te fondeve te miratuara per vitin 2014.

I. Me vendimin Nr.8 date 06.02.2014 eshte miratuar buxheti i vitit 2014, duke perfshire dhe transferen e pakushtezuar dhe te pashpenzuar gjate vitit 2013, sipas kerkesave te ligjit Nr.9936 date 26.06.2008, si dhe udhezimit te Ministrise se Financave Nr.2 date 06.02.2012, pika 99, ku percaktohet se: *Transferta e pakushtezuar qe nuk perdoret plotësisht gjatë vitit buxhetor mbartet për vitin e ardhshëm.*

a. Buxhet i ardhur per vitin 2014:

Nr.	Emertimi	Shuma
1.	Transferte e pakushtezuar	99,814,904
2.	E ardhur & buxheti i pashpenzuar nga viti 2013	11,643,000
TOTALI		111,457,904

b. Struktura e buxhetit te krijuar per vitin 2014:

Nr.	Emertimi	Shuma
1.	Transferte e pakushtezuar per vitin 2014	99,814,904
2.	Buxheti i pashpenzuar nga viti 2013	11,643,000
TOTALI		111,457,904

Transferta e pakushtezuar nga buxheti i shtetit eshte e ardhur per Keshillin e Qarkut, e perfituar ne formen e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes e cila do te perdoret per financimin e shpenzimeve per kryerjen e funksioneve te veta, te deleguara, dhe te perbashketa.

II. Ne administrimin dhe zbatimin e buxhetit per vitin buxhetor 01.01. - 31.12.2014, eshte synuar ne perdorimin me efektivitet te burimeve financiare per kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave te ngarkuara me ligj.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES



SHPENZIMET E NJESISE:

Shpenzimet korente, të cilat përfshijnë shpenzimet për pagat, shpenzimet për kontributin e punëdhënësit për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe shpenzimet e tjera operative, gjatë vitit 2014, paraqiten ne tabelen e mëposhtme:

a. Shpenzimet per funksionet e veta:

G	T	K	A	ANALIZA	PLAN	Fakt
P	T	P	T			
OO	O1110	O5	6001001	Paga Baze	28,843,404	23,846,521
OO	O1110	O6	6001002	Raporte mjekesore	0	87,840
OO	O1110	O5	6001003	Vjetersi	1,997,000	1,934,697
OO	O1110	O5	6001005	Page Grupi	5,520,000	5,789,643
OO	O1110	O5	6001099	Kompensim	240,000	72,000
OO	O1110	O5	6003000	Shperblim Komisione	0	0
OO	O1110	O5	6003900	Shperblim fond.veçant-2012	0	0
OO	O1110	O5	6010100	Kontr.Sig.Shoqerore 16.7% (15+1.7)	5,310,000	4,696,765
OO	O1110	O5	6011100	Kontr.Sig.Shendetsoe 3.4 % (1.7+1.7)	973,000	532,309
			6020		704,855	677,855
OO	O1110	O5	6020100	Kancelari	208,590	208,590
OO	O1110	O5	6020200	Mat.per pastrim dhe sherb,ngrohohje	145,865	145,865
OO	O1110	O5	6020400	Materiale per funksionimin e paisjeve speciale	145,200	145,200
OO	O1110	O5	6020500	Blerje dokumentacioni	30,000	3,000
OO	O1110	O5	6020900	Furnizime dhe mat,Zyre e tjer.	175,200	175,200
			6021		1,588,600	1,588,350
OO	O1110	O5	6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	52,800	52,800
OO	O1110	O5	6021004	Furnizime dhe sherbime me ushqim per mencat	19,400	19,390
OO	O1110	O5	6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale.	770,000	769,760
			6022		1,898,000	1,264,707
OO	O1110	O5	6022001	Shpenzime Energji Elektrike.	400,000	206,264
OO	O1110	O5	6022002	Uji.	100,000	13,800
OO	O1110	O5	6022003	Telefon e Faks.	455,000	454,685
OO	O1110	O5	6022004	Posta dhe sherbime Korijeri.	146,000	144,654
OO	O1110	O5	6022005	Sherbime per ngrohje	120,000	58,800
OO	O1110	O5	6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	30,000	30,000
OO	O1110	O5	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	315,000	314,503
OO	O1110	O5	6022099	Sherbime te tjera.	32,000	32,000
OO	O1110	O5	6022099	Sherbime te tjera.	300,000	10,000
			6023		1,975,200	1,745,816
OO	O1110	O5	6023100	Karburant dhe vaji.	1,275,200	1,275,200
OO	O1110	O5	6023200	Pjese Kembimi, bateri,etjer.	300,000	264,000
OO	O1110	O5	6023300	Siguracion Mjete Transporti.	200,000	44,016
OO	O1110	O5	6023900	Mirmbajtje Rutin e Mjet.Transportit	200,000	162,600
			6024		1,791,196	1,182,934
OO	O1110	O5	6024100	Udhetim Brenda vendit.	1,716,196	1,108,900
OO	O1110	O5	6024200	Udhetim jashte Vendit.	75,000	74,034
			6025		4,340,000	2,179,998
OO	O1110	O5	6025600	Shpenzime mirmbajtje Transporti.	140,000	139,200
OO	O1110	O5	6025400	Shpenz.miremb.rugeve, veprave ujore, rrjete hidraulike	200,000	0
			6026		442,500	442,500

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES**



OO	O1110	O5	6026900	Shpenzime te tjera qiraje	370,500	370,500
			6028		0	0
OO	O1110	O5	6028100	Taksa te pa paguara	0	0
			6029		10,748,089	14,895,222
OO	O1110	O5	6029003	Shpenzime gjyqisore.	20,000	18,000
OO	O1110	O5	6029001	Shpenzime per pritje percjellje	411,300	411,300
OO	O1110	O5	6029002	Shpenz.per aktivitete sociale personelin.	391,500	391,500
OO	O1110	O5	6029006	Shperblim 10% Keshilltaret.	5,927,400	5,927,400
OO	O1110	O5	6029008	Aktivitete social-Kulturore.tr. Tv.kuota etjer	465,000	464,292
OO	O1110	O5	6029099	Perfitim Financiar shpenzim transp.	2,132,889	7,682,730
OO	O1110	O5	6029999	Shoq.verberve,shoq.invalitve,kryqi i kuq.etjer.	600,000	0
OO	O1110	O5	6029999	Kampjonati i Skive Shishtavec	800,000	0
OO	O1110	O5	6029999	Antarsimi ne AER per vitin- 2012	0	0
OO	O1110	O5	6029999	Mirembajtje e godines se QIT	0	0
OO	O1110	O5	6029000	Guida turistike e Qarkut-Kukes	0	0
			231		13,090,500	944,795
OO	O1110	O5	2310000	Riparim dhe paisje zyresh KQK	3,091,000	0
OO	O1110	O5	2312101	Riparim Ndertese-Ambjente-Sanitare (Wcc)	0	0
OO	O1110	O5	2318100	Shpenzime per rritjen e AQT -orendi zyre	0	317,600
OO	O1110	O5	2318600	Paisje Zyrash-Blerje (Compujteri)	0	0
OO	O1110	O5	2313600	Instalim rrjeti Elektrik-Ndertese	0	0
OO	O1110	O5	2313100	Shpenzime per rritjen e AQT - konstruksione te rugeve	9,999,500	300,000
			604	Transferata te ndryshme	15,459,200	11,776,000
			4662210	Kshim garanci punimesh		31,760

b. Transferim buxheti Nderm. Rrugeve Rurale Kukës:

Gr.	Tit	Kap.	Art.	Analiza	Plan buxheti	Plan Thesari	Fakt sipas situacionit	Diferenca (+ ose -)
00	05	04960	600	Paga dhe shitesa mbi pagat	9,240,000	9,240,000	9,198,790	41,210
00	05	04960	601	Kontribut i sig.shoq. e shendetsore	1,559,000	1,559,000	1,496,320	62,680
00	05	04960	602	Mallra dhe materiale	7,000,000	6,325,690	6,325,690	674,310
TOTALI								

c. Transferim buxheti Nderm. Rrugeve Rurale Tropoje:

Gr.	Tit	Kap.	Art.	Analiza	Plan buxheti	Plan Thesari
00	05	04960	600	Paga dhe shitesa mbi pagat	6,904,000	6,904,000
00	05	04960	601	Kontribut i sig.shoq. e shendetsore	1,186,000	1,186,000
00	05	04960	602	Mallra dhe materiale	360,000	360,000
00	05	04960	602	Fond Emergjence- Nd. Rr.Rurale	600,000	600,000
TOTALI						

d. Ndryshimet e buxhetit:

Gjate vitit 2014, Keshilli i Qarkut Kukës ka marre 4 (kater) vendime lidhur me ndryshimet gjate zbatimit të buxhetit të pavarur në lidhje me transferimin dhe rishpërndarjen e fondeve, si dhe me mënyrën e përdorimit të fondit rezervë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj, ku keto ndryshime janë pasqyruar ne tabelat e mesiperme.

III. Të ardhurat e njesise:

Keshilli i Qarkut Kukës ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi, ka patur detyrimin për mbledhje e të ardhurave si dhe menaxhimin e tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES



Te ardhurat e krijuara jane arkëtuar në llogaritë e thesarit në sistemin bankar dhe në llogarinë e unifikuar të thesarit.

Të ardhurat e miratuara në buxhetin e Keshillit të Qarkut Kukës përveç transfertes së pakushtezuar për vitin 2014, janë dhe:

- a. Të ardhurat nga shërbimet e ndryshme që ofron institucioni (të krijuara nga DAMT-ja)
- b. Të ardhura të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta, siç janë të ardhurat e krijuara nga dhënia e lejeve të përdorimit në fushën e planifikimit të territorit.

Pas rakordimit të bërë me Degen e Thesarit-Kukës rezultoi se të ardhurat e krijuara për vitin 2014 për Keshillin e Qarkut Kukës kanë qenë në shumën **659.350 leke**

IV. Kuota e antaresimit të njesive vendore:

Ligji organik për qeverisjen vendore Nr.8652 datë 31.07.2000, neni 18, përcakton detyrimin e komunave/bashkive përberese të Qarkut, që të derdhin kontributet e tyre në buxhetin e qarkut. Neni 73 i ligjit të mesiperm, përcakton kompetencat fiskale të njesive vendore dhe në pikën 8 të tij shprehet se:

- Duke filluar nga 1 janari i vitit 2001 komunat/bashkitë derdhin kontributet e tyre në buxhetin e Qarkut.

Gjithashtu ky detyrim i njesive vendore ndaj qarkut përcaktohet në udhezimin Nr.2 datë 06.02.2012, pika 121 si dhe udhezimin Nr.2 datë 09.01.2015, pika 45. Për vitin buxhetor 2014 asnjë njësi vendore e Qarkut Kukës nuk ka likuiduar këtë detyrim ligjor (*Kuota e antaresimit*) pavarësisht kërkesave të bërë nga ana e saj.

V. Shpenzime personeli:

Kjo kategori shpenzimi (paga) është realizuar në masën 87 %, ndërsa kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në masën 83 %. Nuk ka detyrim ndaj strukturave përkatëse për tatimin mbi të ardhurat nga paga, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në derdhjen e fondeve si dhe kontributin e sigurimit shoqëror suplementar.

Është zbatuar struktura dhe niveli i pagave konform vendimit Nr.4 datë 06.02.2014 të Keshillit të Qarkut Kukës "*Per miratimin e nivelit të pagave të administratës si dhe të masës së shpërblimit të antareve të Keshillit të Qarkut Kukës*"

Për vitin 2014 ka patur një tepër të fondit të pagave në shumën 4,869,703 leke për arsye të mos-përdorimit të fondit të veçantë dhe mungesë personeli sipas strukturës së miratuar.

VI. Shpërblimi i Keshilltareve:

Është realizuar në masën 100 % sipas masës së përcaktuar në vendimin Nr.4 datë 06.02.2014 të KQK-së. Tek ky zë është bërë një planifikim real që në fillim të vitit buxhetor.

VII. Financimet:

Në bazë të vendimit Nr.8 datë 06.02.2014 "*Per miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut Kukës*" është bërë financimi i strukturave të mëposhtme:

a. *Shoqata e të Verberve*. Për vitin 2014 i është akorduar një fond në shumën prej 400.000 leke. Ky fond është transferuar në masën 100 %.

b. *Shoqata e Invalideve të Punes*. Për vitin e mëparshëm kësaj shoqate, i është akorduar një fond në masën 200.000 leke. Ky fond është transferuar në masën 100 %.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI I QARKUT KUKES



c. *Klubi i Mundjes Kukës*. Keshilli i Qarkut Kukës në buxhetin e vitit 2015, i ka akorduar një fond në shumën 2.000.000 leke, për nxitjen, mbështetjen e këtij sporti. Ky fond është transferuar në masën 100 %.

d. *Asambleja e Rajoneve të Europës (AER)*. Pjesëmarrja në aktivitetet e kësaj organizate, ka të bëjë dhe me derdhjen e kuotes së antarsimit, ku për vitin 2014, pas miratimit të fondit nga Keshilli i Qarkut Kukës bërë pagesa në shumën 432.000 leke. Ky fond është likuaduar në llogrën rrjedhëse të kësaj organizate në masën 100 %.

e. *Eventet Lokale*. Në kuadër të bashkëpunimit dhe ndërtimit të politikave rajonale me njesite vendore të Qarkut Kukës, për vitin 2014 janë financuar aktivitete dhe projekte të cilat kanë patur si qëllim kryesor promovimin e vlerave historike, kulturore, artistike të rajonit tone si dhe atraksioneve natyrore. Gjithashtu me vendim të Keshillit të Qarkut Kukës janë financuar dhe aktivitetet e realizuara nga njesite vendore si Komuna Bujan, Komuna Margegaj si dhe Komuna Golaj si dhe organizatat partnere Unioni Artistik Mbarekombetar, SNW, RSL. Këto fonde të akorduara për zhvillimin e aktiviteteve të organizuara nga këto njesi, janë transferuar në masën 100 %.

VIII. Shpenzimet Operative:

Shpenzimet operative për vitin 2014 ishin parashikuar në buxhet në shumën 23,988,440 lekë. Këto shpenzime përbënin rreth 25% të totalit të shpenzimeve korrente. Këto fonde të parashikuara në këtë shpenzim janë realizuar në masën 100 %.

IX. Proçeset gjyqësore:

Sipas dispozitave ligjore në fuqi përcaktohet se të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Për vitin 2014 janë ekzekutuar disa vendime gjyqësore sipas procedurave të ndermarra nga shoqëritë e përmbarrimit gjyqësor, në ngarkim të pëpunësve të administratës si dhe antarëve të Keshillit të Qarkut Kukës. Këto detyrime kanë patur si objekt likuidimin e shumave ndaj subjekteve të telefonisë mobile, institucioneve bankare etj. Likuidimi i këtyre detyrimeve është bërë në bazë të një grafiku të shlyerjes pjesore të pagesave. Gjithashtu për vitin 2014 nuk është ekzekutuar një vendim gjyqësor ndaj një punonjësi, ku për shkak të pamundësisë financiare për likuidimin e tij gjatë vitit 2014, është bërë regjistrimi i këtij detyrimi në sistemin e thesarit konform kërkesave të përcaktuara VKM Nr.335 datë 02.06.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit” si dhe udhëzimit Nr.1 datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njesive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

X. Funkcionet e Deleguara:

Për vitin buxhetor 2014, Keshilli i Qarkut Kukës ka zbatuar destinacionin e fondeve përcaktuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, të ardhur në formën e transferes së kushtezuar me shkresën Nr. 8556 Prot. datë 17.01.2014 për Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes Tokës (DAMT), për pagat, sig. shoq. shëndetsore, si dhe shpenzimet për materialet, në përputhje me rregullat e menaxhimit financiar. Këto fonde janë zbatuar në masën 100 %.

